



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government
Ministria e Financave dhe Transfereve
Ministarstvo za Finansije i Transfere – Ministry of Finance and Transfers
Departamenti i Buxhetit / Odeljenje za budžet / Budget Department

Takimi i Komisionit të Granteve
(datë: 22 Prill 2020, e mërkurë, 10:00-12:00)

Procesverbali i takimit:

Me datë 22 Prill 2020, në sallën e takimeve P 38 kati 0 , u zhvillua takimi i Komisionit të Granteve ku sipas agjendës u diskutua “Shqyrtimi dhe aprovimi i Granteve Qeveritare për financimin e komunave për vitin 2021-2023 në kontekst të finalizimit të KASH 2021-2023 përfshirë kriteret dhe ndarjen e granteve sipas LFPL. Këtë takim e kryesoi Ministri i Financave dhe Transfereve z. Besnik Bislimi.

Pjesëmarrësit:

Z. Besnik Bislimi, ministër i Financave dhe Transfereve, Hykmete Bajrami, ministre e Ministrisë së Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit, Emilija Rexhepi, ministre e Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal, Hekuran Murati, Kryetar i Komisionit për Buxhet e Financa, Kuvendi i Kosovës, Besim Ilazi, Kryetar i Komunës së Kaçanikut, Refki Suma, Kryetar i Komunës së Hanit të Elezit, Salvador Elmazi, Drejtor i Departamentit të Buxhetit, Jeton Gashi, Kryesues i Sekretariatit të Komisionit të Granteve,

Agjenda - qëllimi i takimit:

- Shqyrtimi dhe aprovimi i financimit komunal për vitin 2021 dhe
- Të ndryshme

Z. **Besnik Bislimi**, Ministër në MFT i përshëndeti të pranishmit me mirëseardhje si dhe i informoi anëtarët e Komisionit të Granteve për rolin dhe përgjegjësitë e anëtarëve të rinj të Komisionit të Granteve, të përcaktuar me Ligjin për Financat e Pushtetit Lokal dhe për parimet bazë të dokumentit udhëzues për anëtarët e Komisionit të Granteve për vitin 2021 mbi ndarjen e granteve qeveritare për financimin komunal 2022-2023.

Më tutje Ministri theksoi se parimet, kriteret dhe formulat e zbatuara për ndarjen e granteve qeveritare për financimin e komunave për vitin 2021 bazohen në Ligjin për Financat e Pushtetit Lokal (LFPL).

Burimet e Financimit Komunal për vitin 2021-2023 janë:

1. Granti i Përgjithshëm,
2. Granti shtesë për Financimin e Kryeqytetit,
3. Granti specifik për arsim parauniversitar,
4. Granti specifik për shëndetësi primare,
5. Financimi për shëndetësinë sekondare,
6. Financimi për shërbimet rezidenciale,
7. Financimi për qendrën historike të Prizrenit, fshatin Zym dhe Hoçë e Madhe,
8. Financimi për zonën e rrezikuar mjedisore të Obiliqit,
9. Financimi për teatrot, si dhe
10. Projeksionet e të hyrave vetanake komunale.

Granti i Përgjithshëm

Sa i përket Grantit të Përgjithshëm për vitin 2021 Ministri theksoi se ky grant është në shumë prej 190.49 milion €, krahasuar me vitin 2020 ka një rënie prej 5.7 milion euro për arsyeje se ka rënie të të hyrave të përgjithshme.

Të hyrat e përgjithshme qeveritare për vitin 2021 pritet të jenë 2,006.8 milion euro nga kjo shumë, zbriten ato të hyra siç specifikohet në nenin 24 të LFPL dhe vijmë tek baza për ndarjen e grantit të përgjithshëm për komuna.

Kjo ndarje bazohet në formulën e përcaktuar në nenin 24 të LFPL: (i) numri i popullsisë llogaritet me tetëdhjetë e nëntë përqind (89%); (ii) përmasat gjeografike të komunës me gjashtë përqind (6%); (iii) numri i popullsisë pakicë në komunë me tre përqind (3%); (iv) komunat ku shumica e popullsisë së të cilave përbëhet nga pakicat me dy përqind (2%).

Granti i përgjithshëm u hodh në votim dhe u aprovua me vota unanime në shume prej 190.49 mil. euro.

Granti shtesë për Financimin e Kryeqytetit

Bazuar në Ligjin Nr. 06/L-012 për Kryeqytetin e Republikës së Kosovës, për vitin 2021 përfiton grant shtesë në shume prej 11.42 mil.euro, krahasuar me vitin 2020 ka një rënie prej 0.3 milion euro, si rezultat i rënies së të hyrave të përgjithshme

Granti shtesë për Financimin e Kryeqytetit u hodh në votim dhe u aprovua me vota unanime në shumë prej 11.43 mil. euro.

Granti specifik për arsim parauniversitar,

Sa i përket Grantit Specifik për Arsim, Ministri theksoi se ky grant për vitin 2021 është në shumë prej **192 milion euro** - grant bazë si vijon: Paga dhe mëditje 175.5 mil.€, Mallra dhe shërbime 14 mil €, Shpenzime Kapitale 2.5 mil.€.

Sipas LFPL, kjo ndarje bazohet në sistem të hapur të financimit, duke marrë parasysh kriteret në formulën e arsimit parauniversitar të propozuar nga MASHTI për vitin 2021.

Po ashtu ministri e ngriti edhe shqetësimin rreth saktësisë se te dhënave te paraqitura ne propozim Grantin specifik, ku edhe bëri disa krahasime në mes të komunave me numrin e popullsisë.

Po ashtu ministri sqaroi për të pranishmit se ndryshimi në propozim Grantin specifik për arsim ka ardhur pasi që kalkulimi i pagave është bërë sipas mesatares se pagës aktuale e jo sipas ligjit të ri për pagat në sektorin publik.

Me këtë rast iu dha fjala Ministres së MASHTI-t e cila në detaje i sqaroi të gjitha politikat e reja të propozuara nga MASHTI.

Ministri i Financave kërkoi që për vitin 2021 përveç grantit bazë prej 192 milion euro grantit specifik t'i shtohen edhe këto politika te reja siç janë:

1. Pagat jubilarë sipas kontratës kolektive për Arsim, me kosto prej 1.1 milion euro,
2. Paga për parafillor për shkolla (2 deri në 5 vjeç) për vitin 2021, me kosto prej 1.6 milion euro,
3. Mallra dhe Shërbime për fëmijë (4 deri në 5 vjeç), me kosto prej 0.07 milion euro,
4. Kosto e pagesës së procedurave për validim dhe akreditim për shkollat e mesme të larta profesionale (8 Shkolla), me kosto prej 38,400 euro.

Z. Bajrami, ministre e Ministrisë së Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit kërkoi që të përfshihen edhe politikat e tjera pasi që janë shumë të rëndësishme dhe të domosdoshme për arsimin parauniversitar.

Z.Bislimi, ministër i Financave dhe Transfereve kërkoi mirëkuptimin e ministres pasi që gjendja e të hyrave është jo e mirë për shkak të pandemisë COVID 19 në të cilën gjendemi dhe nuk dihet se sa do të zgjas, do të shikohet mundësia që gjate procesit buxhetor të përfshihen edhe ato politika nëse ka hapësirë buxhetore.

Pas shumë diskutimeve z.Bislimi vendosi që ta hedh në votim propozim grantin specifik për arsim.

Granti specifik për arsim parauniversitar, u hodh në votim dhe u aprovua me vota unanime në shumë prej 194.8 mil. Euro.

Granti specifik për shëndetësi primare,

Granti specifik për shëndetësi primare për vitin 2021 është në shumë prej 61.7 milionë euro. Shpërndarja e grantit specifik për shëndetësi bazohet në sistem të hapur në përputhje me LFPL. Granti specifik për shëndetësi primare për vitin 2020 është përgatitur sipas kriterit për kokë banori dhe në pajtim me rekomandimet e Komisionit të Granteve të dala nga raporti vjetor mbi Vlerësimin e Përshtatshmërisë së Sistemit të Financimit Komunal.

Ministri i Financave kërkoi që përveç grantit bazë prej 61.7 milion euro të shtohen edhe një politikë e re e paraparë nga MSH siç është vizitat e kujdesit paliativ (vizitë x 20 euro) me kosto prej 0.9 milion euro, kurse politikat e tjera të propozuara nga MSH nuk patën arsyeshmërinë e nevojshme për të kaluar.

Granti specifik për shëndetësi primare u hodh në votim dhe u aprovua me vota unanime në shumë prej 62.6 mil.euro.

Financimi për shëndetësinë sekondare

Financimi për shëndetësinë sekondare për vitin 2021 është në shumë prej 2,603,077 €.

Financimi për shëndetësinë sekondare, u hodh në votim dhe u aprovua me shumicë të votave.

Financimi për shërbimet rezidenciale

Financimi i shërbimeve rezidenciale për shtëpitë e komunitetit për vitin 2021 është në shumë prej 2.3 milion euro.

Për vitin 2021 në kuadër të këtij propozimi është paraparë rritja e stafit prej 13 dhe financimi shtesë për funksionalizimin e Shërbimeve Rezidenciale për personat e moshuar në komunën e Prizrenit.

Financimi për shërbimet rezidenciale për vitin 2021 krahasuar me vitin 2020 ka një rritje prej 0.2 milion euro.

Financimi për shërbimet rezidenciale u hodh në votim dhe u aprovua me shumicë të votave.

Financimi për qendrën historike të Prizrenit, fshatin Zym dhe Hoçë e Madhe

Financimi për qendrën historike të Prizrenit, fshatin Zym dhe Hoçë e Madhe për vitin 2021 është në shumë prej 69,393 euro, për dy komunat si vijon: Komuna e Prizrenit, në shumë prej 44,365 euro, dhe Komuna e Rahovecit, në shumë prej 25,028 euro.

Financimi për qendrën historike të Prizrenit, fshatin Zym dhe Hoçë e Madhe u hodh në votim dhe u aprovua me shumicë të votave.

Financimi për zonën e rrezikuar mjedisore të Obiliqit,

Për vitin 2021 Komuna e Obiliqit bazuar në inkasimin e rentës minerale përfiton financim shtesë prej 4.6 milion euro. Për këtë çështje u debatua nga anëtarët e KG ku u ngrit shqetësimi i disa komunave që nuk kanë të njëjtin trajtim siç e ka Komuna e Obiliqit me këtë ligj.

Pas diskutimeve Ministri i Financave e hodhi në votim ku me shumicë votash u aprovua financimi për Obiliqin.

Financimi për Teatro

Financimi për Teatrot për vitin 2021 është në shumë prej 900,000 euro, po ashtu edhe ky financim pasi u elaborua nga Ministri i Financave u hodh në votim dhe me shumicë të votave kaloi.

Projeksionet e të Hyrave Vetanake Komunale

Projeksionet e të hyrave vetanake komunale për vitin 2021 bazuar, në vlerësimet makro-fiskale, janë në shumë prej 87.2 milion euro nga të cilat: 50 mil.€ janë paraparë taksa ngarkesa dhe të hyra tjera jo tatimore, 37.2 mil.€ janë paraparë të hyra të tatimit në pronë dhe në tokë.

Projeksionet e të hyrave vetanake komunale për vitin 2021 krahasuar me vitin 2020 kanë një rritje prej 4 milion euro.

Pasi u diskutua nga anëtarët projeksioni i të hyrave vetanake prej 87.2 milion euro u hodh në votim nga Ministri por nuk kaloi, dhe me propozim të ministrit të MFT mbet qe projeksionet e të hyrave të janë në nivelin e njëjtë me vitin 2020 në vlerë 83 mil.eur, ku anëtarët e KG duhet të deklarohen a pajtohen apo jo përmes emailit.

Pika e dytë sipas agjendës - të ndryshme

1. Nga kryesuesi i KG, ministri i MFT u ngrit për diskutim çështja që ka të bëjë me projektin e KfW për efikasitet të energjisë në katër komuna: Prishtinë, Gjakovë, Gjilan dhe Ferizaj, dhe u aprovua në parim që të vazhdohet me këtë projekt për këto komuna.

2. Po ashtu nga kryesuesi i KG, ministri i MFT u ngrit për diskutim çështja që ka të bëjë me numrin e stafit në komuna, staf i cili është i aprovuar por i pa punësuar. Në këtë rast ministri i MFT Besnik Bislimi u sqaroi anëtarëve të KG se sipas nevojës komunat që kanë staf të pa punësuar nëse nuk është në procedurë të punësimit dhe është i pa nevojshëm si numër të zbritet. Për këtë çështje pat shumë diskutime nga përfaqësuesit e Komunave dhe po ashtu u kërkua nga Kryetari i Hanit të Elezit dhe ministrja e Ministrisë së Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit që dy çerdhet njëra në Vushtrri dhe tjetra në Komunën e Hanit të Elezit të rritet stafi për nga 13 dhe të behën funksionale pasi që këtyre çerdheve u mungon vetëm stafi për t'u funksionalizuar. Ministri i Financave dhe Transfereve u zotua se kjo çështje mund të zgjidhet me procesin e rishikimit pasi që Ligji i Buxhetit për vitin 2020 nuk lejon që gjatë procesit të rritet stafi.

Vërejtje: Ky procesverbal iu është dërguar anëtarëve të Komisionit të Granteve (KG) për komente, dhe nuk ka patur komente nga anëtarët e KG.